



KOMITETI OLIMPIK  
KOMBETAR SHQIPTAR

Qershor - Korrik - Gusht  
2009

# KOKSH

## Informacione



PESCARA 2009™

XVI JEUX MEDITERRANEENS  
XVI GIOCHI DEL MEDITERRANEO  
XVI MEDITERRANEAN GAMES

ألعاب البحر الأبيض المتوسط السادسة عشر



# Shqipëria në Lojërat Mesdhetare “Pescara 2009”

Adresa: Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Rr. “Muhamed Gjollësja”,  
Sheshi “Mustafa K. Atatürk” (ish 21-dhjetori), Tiranë-Albania  
Tel: +355 4 235 249 / 240 602, Fax: +355 4 240 565,  
e-mail: [secretariat@nocalbania.org.al](mailto:secretariat@nocalbania.org.al) / [www.nocalbania.org.al](http://www.nocalbania.org.al)

## Lojërat Mesdhetare "Pescara 2009" – Edicioni 16



Ceremonia e çeljes në Lojërat Mesdhetare "Pescara 2009"

Përfaqësimi i Shqipërisë në edicionin e XVI të Lojërave Mesdhetare që u zhvilluan në Pescara të Italisë në datat 26 Qershor – 5 Korrik 2009, shënoi dhe një tjetër arritje: Shqipëria u përfaqësua me delegacionin më të madh në historinë e pjesëmarrjeve tona në Lojërat Mesdhetare. Ishin 220 sportistë, trajnerë dhe zyrtarë që përfaqësuan në këto lojëra 17 disiplina sportive: Atletikës, Basketbollit, Boksit, Beach-Volej, Çiklizmit, Futbollit, Gjimnastikës, Hendbollit, Karatesë, Mundjes, Notit, Qitjes, Peshëngritjes, Pingpongut, Volejbollit, Vozitje dhe Xhudos. Disa prej këtyre sporteve si individuale ashtu dhe ekipore përfaqësoheshin për herë të parë në një eveniment mesdhetar dhe përballeshin për herë të parë me nivele kaq të larta sportive.

Për ta pjesëmarrja në këto lojëra ishte një eksperiencë shumë e vlefshme për tu njohur me standartet e konkurrimit të niveleve Olimpikë. Një mundësi që KOKSH ua dha të gjitha sporteve në edicionin e këtij viti duke rritur jo vetëm numrin e sportistëve pjesëmarrës por dhe të sporteve përfaqësuese, ndihmuar nga afërsia gjeografike me vendin organizator si dhe kushtet lehtësuese të akomodimit.

Në 7 pjesëmarrjet e saj në Lojërat Mesdhetare, Shqipëria numëron në total 33 medalje (ari, argjendi, bronzi). Këto janë tregues që sporti shqiptar ka aftësinë të konkurrojë denjësisht në aktivitete të nivelit të lartë siç janë Lojërat Mesdhetare dhe sigurisht më kulmoret Lojërat Olimpikë.

Ashtu si dhe në përfaqësimet ndër vite në Lojërat Mesdhetare edhe në "Pescara 2009" nuk munguan medaljet. Peshëngritësit tanë që kanë qenë dhe janë pjesë e programit të bursave Olimpikë, arritën të ngjiteshin në podin e medaljeve mesdhetare 6 herë: 2 medalje ari, 4 medalje argjendi. Nuk mbeten prapa dhe sportet e tjera që përfaqësoheshin për herë të dytë në këto lojëra. Xhudoja ishte një nga surprizat e pjesëmarrjes tonë në këto lojëra. Pas eksperiencës në Lojërat Olimpikë "Pekin 2008" sportistët shqiptarë të xhudos ishin konkurrentë të denjë në Lojërat Mesdhetare duke u shfaqur pretendetë për medalje. E ndër sportet që u përfaqësuan për herë të dytë në edicionin e XVI të Lojërave Mesdhetare si Hendbolli apo dhe Kanotazhi kjo pjesëmarrje ishte një eksperiencë shumë e vlefshme për zhvillimin e këtyre sporteve në vend.



Atletik



Basketboll



Beach Volej



Çiklizëm



Futboll



Gjimnastik



*Handboll*



*Karate*



*Mundje*



*Nat*



*Peshëngritje*



*Ping Pong*



*Shije*



*Volejbol*



*Voziqe*

Në “Pescara 2009” kemi rikthimin në aktivitetet mesdhetare të futbollit shqiptar që në këto lojëra u përfaqësua me ekipin kombëtar të U-20.

Megjithë vizionin e ri të përhapjes “gjeografike” të pjesëmarrjes si me sportistë ashtu dhe në sporte, KOKSH hasi mungesë bashkëpunimi në këtë sipërmarrje. Një sipërmarrje që rrezikoi të dështonte për shkak të konflikteve që u krijuan mes institucioneve sportive në vend madje dhe me ato ndërkombëtare ku për herë të parë u rrezikua seriozisht pjesëmarrja e Shqipërisë në edicionin e XVI të Lojërave Mesdhetare që do të kishte pasoja të mëdha për sportin shqiptar jo vetëm në arenën konkurruese por dhe në marrëdhëniet e bashkëpunimit mes institucioneve tona sportive me ato ndërkombëtare.



*Judo*



Pavarësisht se fryma e bashkëpunimit ndër-institucional mungoi në përgatitjet e pjesëmarrjes së delegacionit mesdhetar në këto Lojëra, gjë që u pa edhe në mënyrën e financimit nga MTKRS, duke kapërcyer vështirësitë, KOKSH arriti të organizonte dhe të dërgonte në Pescara delegacionin më të madh sportiv në gjithë historinë e pjesëmarrjeve tona dhe të bënte të mundur ngritjen e flamurit shqiptar në Edicionin e XVI të Lojërave Mesdhetare “Pescara 2009”. Në përfundim Shqipëria u rendit e 13-ta në klasifikimin përfundimtar të rezultateve nga 23 shtete pjesëmarrëse në këto Lojëra.

Pamje nga ceremonia e mbylljes së lojërave.

## Mesazhi i Presidentit të KOKSH Hysen Domi për Lojërat Mesdhetare “Pescara 2009”

Pjesëmarrjet në veprimtaritë e mëdha sportive ndërkombëtare si Olimpiadat, Lojërat Mesdhetare etj, gjithmonë janë evenimente të vecanta, mbresëlënëse, përfaqësuese. Ballafaqimet sportive, njerëzore e sociale të një rajoni të tërë, janë një shans i shkëlqyer për të prezantuar kombin tënd, në të gjitha drejtimet.

E tillë ishte dhe pjesëmarrja jonë në Lojërat e 16ta Mesdhetare të Pescarës në I tali. Për shumë arësye objektive, të afërsisë gjeografike, të dëshirës për t’u përfaqësuar në mjaft disiplina sportive, të predispozitës lavdëruese për ta mbështetur këtë veprimtari, delegacioni ynë sportiv shënoi rekord në numrin e pjesëmarrjes dhe në lloje sporti, në një aktivitet të tillë si Lojërat Mesdhetare.

Sigurisht të japin kënaqësi të madhe rezultatet e larta të peshëngritjes apo dhe disiplina të tjera por unë e konsideroj një shkollë të madhe, një eksperiencë të fituar, një mundësi për tu ballafaquar por dhe një analizë të hollësishme e të gjithanëshme të sportit tonë, në raport me vendet Mesdhetare.

Ja përse do ti quaja Lojërat e 16ta Mesdhetare të Pescarës në I tali, të rëndësishme e të dobishme për të marrë gjithmonë pjesë.

Gjej rastin për të përshëndetur të gjithë pjesëmarrësit: drejtues, trajnerë, sportistë e specialistë të tjerë për kontributin e tyre në përfaqësimin e vendit tonë, të kulturës sonë, në këto veprimtari.

Ju faleminderit për gjithcka,  
Hysen Domi

### Fitues të medaljeve në këto lojëra



**Erkand Qerimaj**  
**ARI**  
Kategoria (M) 77 kg  
Shkeputje 156kg

**ARGJEND**  
Kategoria 77 kg  
Shtytje 193kg



**Romela Begaj**  
**ARI**  
Kategoria (F) 58 kg  
Stili Shkeputje 95kg

**ARGJEND**  
Kategoria 58 kg  
Shtytje 110kg



**Ervis Tabaku**  
**ARGJEND**  
Kategoria (M) 85 kg  
Shkeputje 166kg



**Briken Çalja**  
**ARGJEND**  
Kategoria (M) 69 kg  
Shkeputje 142kg

## EYOF "Tampere 2009"



Edicioni i 10-të i Festivalit Olimpik Rinor Europian i cili u organizua në qytetin e Tampere në Finlandë mbledhi sportistë të rinj nga 49 vende të Europës. Festivali i cili filloi zyrtarisht me ceremoninë e hapjes datë 19 Korrik u përshëndet nga autoritetet më të larta të Levizjes Olimpikë Botërore dhe Europiane si Dr. Jacques Rogge - President i IOC, z. Patrick Hickey - President i EOC, dhe nga autoritetet vendore.

Dr. Jacques Rogge i cili ndryshe emertohet edhe si babai i këtij festivali pasi ishte inisiativa e tij kur ka qenë President i EOC theksoi rëndësinë e këtij festivali si dhe vlerat në të cilin lojërat e këtij edicioni u bazuan:

- Sportiviteti - Sporti dhe sportistët janë roli kryesor me vlerat Olimpikë dhe Edukimi Olimpik.
- Ekologjia e qëndrueshme - Ajër dhe qytet i pastër, mund të pish ujë çezme kudo, ushqim i mirë dhe i shijshëm, menaxhim i mbeturinave dhe riciklim, përdorim i transportit publik sa më shumë të jetë e mundur.
- Ekonomia - Vendet e garave me kushte të mira dhe të pajisura, ushqim dhe ujë i mjaftueshëm, sporti funksionon, organizim i mirë por jo shumë pompoz.

Në programin e EYOF bënin pjesë 9 disiplina sportive: Atletikë, Basketboll, Çiklizëm, Gjymnastikë, Hendboll, Not, Tenis, Volejbol, Xhudo.

Shqipëria u përfaqësua në këtë Festival me një ekip modest dhe mori pjesë në tre disiplina sportive të përfaqësuar nga sportistët:



**Gerti Dajti**  
Atletike - 100m  
rezultati 12,27



**Henrik Kovaci**  
Xhudo – 66kg  
Shorti e kalon në raundin e dytë por humbet në raundin e radhës me sportistin nga Bosnja-Hercegovina Stefan Majdov për të mos patur mundësinë e vazhimit të garës.



**Velia Olsjan**  
Kronometer 7.1km ->  
rezultati 11:14,97  
Mori pjesë edhe në garat e circuitit dhe të rrugës por nuk arriti të klasifikohej.

## Aktivitete të radhës për vitin 2010

Lojërat Olimpikë Dimërore  
"Vancouver 2010",  
12 - 28 Shkurt 2010



Lojërat Olimpikë Rinore  
"Singapore 2010",  
14 - 26 Gusht 2010



## Asambleja Zgjedhore e datës 14 korrik 2009



Në 14 korrik 2009 u mbajt Asambleja 14-të e Përgjithshme Zgjedhore e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar me subjekt zgjedhjen e organeve drejtuese të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, pas përfundimit të mandatit të tyre 4-vjeçar.

Kjo asamble u mbajt në ambjentet e Hotel Sheraton, në Tiranë.

Të ftuar ishin Jerome Poivey, përfaqësues i CIO; Dermot J. Sherlock, përfaqësues i CEO dhe Vasil Bicaj, Drejtor i Sportit në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, dhe inspektor z. Arjan Konomi.

### Rendi i ditës së Asamblesë ishte:

- Fjala e hapjes nga z. Hysen Domi, President i KOKSH
- Ngritja e Komisionit të Verifikimit të Mandateve dhe verifikimi
- Ngritja e Komisionit të Votimit
- Prezantimi i kandidatëve
- Fjala e kandidatit për President
- Procedura dhe mënyra e votimit
- Procesi i votimit, numërimit të votave dhe shpallja e rezultateve
- Fjala përsëritëse e Presidentit të zgjedhur nga Asambleja dhe mbyllja e punimeve



Gjithashtu asambleja u ndoq gjerësisht nga media e shkruar dhe elektronike gjatë gjithë zhvillimit të saj.

Në përfundim të procesit të votimit rezultuan: president i KOKSH z. Agim Fagu, sekretar i përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello, anëtarë të Komitetit Ekzekutiv : Ela Tase, Flobens Dilaveri, z.Genc Boga, Gezim Panariti, Hyrmete Gjeta, Majlinda Pilinci, Skënder Anxhaku, Viron Bezhani dhe Vojo Malo.

Asambleja vlerësoi kontributin e z. Domi gjatë periudhës 8-vjecare si President i KOKSH dhe të gjithë anëtarët e Asamblesë zgjedhën z. Domi President Nderi të KOKSH mes duartrokitjeve.

Presidenti i sapozgjedhur i KOKSH, z. Agim Fagu, në fjalën e tij përsëritëse, falenderoi të pranishmit për besimin që i dhanë dhe prezantoi angazhimet e tij.



## Mesazh i Presidentit të ri të KOKSH z. Agim Fagu i zgjedhur në Asamblenë e 14-të



Asambleja e 14-të Zgjedhore e KOKSH e datës 14 Korrik 2009 u zhvillua në frymën e konsensusit, mirëkuptimit dhe vlerësimit realist të situatës, jo vetëm në Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, por çështë më e rëndësishmja të Lëvizjes Olimpike dhe Sportive Shqiptare, dhe të ecures së tij. Vlerësimet e kuadrove të sportit dhe shoqërisë civile, duke veçuar edhe organizmat më të larta sportive botërore të angazhuara në këtë proces, të japin besim për potencialin, kuptimin e drejtë dhe gadishmërinë që komuniteti sportiv mbart për të kontribuar në ngritjen e institucioneve dhe praktikave më të përparuara Olimpike, që i bëjnë nder Lëvizjes Olimpiste dhe Sportit në Shqipëri.

Personalisht ndjem i nderuar dhe i privilegjuar që mora besimin, mbështetjen dhe inkurajimin e sinqertë të gjithë Asamblesë, për këtë detyrë të bukur e me përgjegjësi, që të jep mundësi të kontribuosh drejtpërdrejtë në favor të zhvillimit të Lëvizjes Olimpike dhe Sportive, që ndikon masivisht në edukimin e një shoqërie të shëndetshme fizikisht, mendërisht e moralisht. Së bashku me kolegët e mijë të zgjedhur në organet drejtuese jemi të ndërgjegjshëm jo vetëm për vlerat dhe rëndësinë e punës tonë, por çështë më kryesorja të sfidave të shumta që kemi përpara e që kërkojnë përkushtim, dije, programe të qarta e bashkëpunim të hapur me aktorët shtetërore dhe civile që janë të interesuar për zhvillimin e Lëvizjes Olimpike Sportive në Shqipëri.

Pavarësisht nga sfidat e shumta dhe realiteti i vështirë në të cilën ndodhet sporti shqiptar, personalisht kam bindjen se duke bashkuar angazhimin tonë të sinqertë, kontributet e përbashkëta intelektuale, si edhe potencialet dhe eksperiencën e vyer kombëtare dhe ndërkombëtare, ne do të mundësojmë realizimin e misionit dhe rolit të KOKSH për promovimin e Olimpizmit, edukimit të rinisë përmes sportit të pastër e larg dhunës, për zhvillimin e sportit për të gjithë, larg diskriminimit të çdo lloji, duke dhënë kështu kontributin tonë për zhvillimin e lëvizjes sportive në përgjithësi e atij elitare në veçanti.

Në mbyllje, gjej rastin t'ju falënderoj edhe një here për mbështetjen dhe besimin e dhënë dhe t'ju ftoj të gjithëve, kuadro të sportit, sportistë, drejtues institucionesh publike dhe private, intelektuale e dashamirës të sportit të bashkojmë energjitë dhe dijet tona për zhvillimin e sportit në Shqipëri, në shërbim të së ardhmes së shoqërisë tonë.

Ju garantoj se tek KOKSH do të gjeni një partner mikpritës e të besueshëm, të hapur e vlerësues për angazhimin e marrë.

Me mirënjohje,  
Agim Fagu

# Dita Olimpike

Elbasan "Miqte e Maliit" - Bukanik 5-6 Qershor 2009



Pogradec "Dita Olimpike Liqenore" 20 Qershor 2009



Tirane – Dita Olimpike "Marikaj" 31 Maj 2009



Vlore – Java Olimpike Shkolla "Lef Sallata" Maj 2009

